

Pëlqim i informuar për tabletat me jodur kaliumi

Pëlqim i informuar për marrjen e tabletave me jodur kaliumi

Të nderuar prindër! Të nderuar kujdestarë!

Për më shumë se 30 vjet, Ministria e Shëndetësisë e Austrisë ka ofruar tableta me jodur kaliumi pa pagesë për popullatën – duke përfshirë shkollat dhe kopshtet.

Pse dhe kur është e rëndësishme të merren tabletat me jodur kaliumi?

Në rast emetimi jodi radioaktiv për shkak të ndonjë aksidenti në central bërthamor, tabletat me jodur kaliumi i sigurojnë trupit jod të qëndrueshëm, duke parandaluar kështu ekspozimin e lartë të gjëndrës tiroide ndaj rrezatimit.

Pse është e rëndësishme të merren në kohë tabletat me jodur kaliumi në rast aksidenti në ndonjë reaktor? Tabletat me jodur kaliumi mbrojnë vetëm nëse merren PËRPARA mbërritjes së masave të ajrit radioaktiv. Kjo i jep trupit kohë për të "ndërtuar" mbrojtjen. Për të siguruar shpërndarjen në kohë për fëmijën tuaj, institucionet arsimore janë të pajisura paraprakisht me tabletat në fjalë.

Kur dhe me udhëzimin e kujt bëhet shpërndarja e tabletave me jodur kaliumi në shkollë?

Tabletat mund të administrohen vetëm me kërkesë të shprehur të autoriteteve të mbrojtjes nga rrezatimi. Shkollës i nevojitet pëlqimi juaj për t'i dhënë fëmijës jodurin e kaliumit mbrojtës për ta marrë në shtëpi nga shkolla vetëm në rast të një rreziku të afërt bërthamor - dhe që duhet gëlltitur me kërkesë të autoriteteve të mbrojtjes nga rrezatimi.

Lexoni me kujdes udhëzimet e bashkëngjitura nga fletëpalosja e tabletave me jodur kaliumi dhe jepini fëmijës suaj formularin e nënshkruar të pëlqimit për ta sjellë në shkollë. Faleminderit!

(Formularët e pëlqimit mund t'i gjeni dhe në internet në gjermanisht dhe 12 gjuhë të tjera: Shabllonet për printim: www.schularzt.at)

Drejtoria

DEKLARATË PËLQIMI

Emri i fëmijës:

Datëlindja:

Emrat e kujdestarëve:

- PO, jap pëlqimin (për kohëzgjatjen e vizitës në institucion) për t'i dhënë fëmijës tim tableta me jodur kaliumi me kërkesë të autoriteteve të mbrojtjes nga rrezatimi. Konfirmoj se nuk kam dijeni për ndonjë intolerancë apo kundërintikacion për marrjen e tabletave nga fëmija im dhe se do të informoj menjëherë shkollën nëse vihem në dijeni për ndonjë intolerancë ose kundërintikacion.
- JO, nuk jap pëlqimin

Data:

Nënshkrimi:

Informacion për tabletat e jodurit të kaliumit (në përputhje me udhëzuesin e përdorimit)

Tabletat e jodurit të kaliumit nuk lejohet të përdoren kur ke:

- **një funksionim mbi normën, pra një mbifunksion të gjëndrës tiroide**
- **tumore beninjë në gjëndrën tiroide**, të cilët nuk kurohen. Në rast të të ashtuquajturit “tumor i nxehtë i gjëndrës tiroide”, që nuk kurohet, ekziston rreziku i një mbiprodhimi shumë të madh të hormoneve të gjëndrës tiroide, që në rastin më të keq mund të çojë në reaksione të sistemit kardiovaskular të rrezikshme për jetën.
- **alergji** (ndjeshmëri të theksuar) ndaj jodit. Kjo gjë është tepër e rrallë dhe nuk duhet ngatërruar me alergjinë e shpeshtë ndaj mjeteve të kontrastit (që shërbejnë për një pasqyrim më të mirë të organeve të ndryshme në ekzaminimet radiografike, si p. sh. gjatë diagnostikimit me rreze Röntgen).
- **alergji** ndaj njërit prej përbërësve të tjerë të tabletave (niseshte misri, monohidrat laktoze, celulozë mikrokristaline, butilmetakrilat-kopolimer bazik, stearat magnezi).
- **Dermatitis herpetiformis Duhring** (një sëmundje që shkakton flluska, skuqje të lëkurës, ekzemë, pezmatim dhe kruarje të fortë djegëse sidomos te bërrylat dhe gjunjët).
- **pezmatim të mureve të enëve të gjakut** si pasojë e alergjisë (Vaskulit hipokomplementemik).

Kujdes i veçantë gjatë marrjes së tabletave të jodurit të kaliumit kërkohet në rastet kur:

- **dyshohet për një tumor malinj të gjëndrës tiroide**. Tumoret e gjëndrës tiroide trajtohen me jod radioaktiv. Marrja në sasi të madhe e jodurit të kaliumit mund ta bëjë të pamundur trajtimin e tumoreve.
- ka një sëmundje që lidhet me **fytin**. Si pasojë e sasive të mëdha të jodit gjëndra tiroide mund të rritet, çka e keqëson më tej një ngushtim të trakesë që ekziston tashmë.
- kur fëmija juaj mjekohet me substanca që e frenojnë **gjëndrën tiroide (Thyreostatika)**. Pyesni, ju lutemi, mjekun ose mjeken tuaj, nëse fëmija juaj lejohet t’i marrë tabletat e jodurit të kaliumit.

Marrja e tabletave të jodurit të kaliumit paralelisht me medikamente të tjera

- **Efekti i tabletave të jodurit të kaliumit ndikohet nga:**
medikamente, të cilat ndikojnë në metabolizmin e gjëndrës tiroide (p. sh. perklorat, tiocianat me përqëndrim mbi 5 mg/dl). Ato frenojnë marrjen e jodit nga gjëndra tiroide.
- **Tabletat e jodurit të kaliumit ndikojnë në veprimin e:**
lëndëve që frenojnë gjëndrën tiroide (Thyreostatika)

Joduri i kaliumit G. L. përmban laktozë. Pyesni, ju lutemi, mjekun ose mjeken tuaj, nëse fëmija juaj lejohet të marrë tableta të jodurit të kaliumit.

Çfarë efektesh anësore mund të ndodhin?

Si të gjitha medikamentet edhe tabletat e jodurit të kaliumit mund të kenë efekte anësore, të cilat nuk është e thënë të shfaqen te çdo njeri:

Rrallë (mund të prekë deri në 1 prej 1.000 pacientëve):

- një alergji e panjohur nga jodi mund të shfaqet për herë të parë. Në këtë rast mund të shfaqen dukuri alergjike, si p. sh. skuqje të lëkurës, kruarje dhe djegie e syve, rrrufë, kollë e thatë, heqje barku, dhimbje koke dhe shqetësime të ngjashme. Sidomos kur personi është i sëmurë me Dermatitis herpetiformis Duhring (një sëmundje që shoqërohet midis të tjerash me flluska dhe skuqje të lëkurës, veçanërisht te bërrylat ose gjunjët) janë të mundshme reaksione të rrezikshme për jetën (shih më lart: “Kur nuk duhet të merren tabletat e jodurit të kaliumit”).
- Pezmatim i enëve të gjakut (p.sh. Periarteriitis nodosa).

Shumë rrallë (mund të prekë deri në 1 nga 10.000 pacientë):

- mbi- ose nënfunksion të gjëndrës tiroide që shkaktohet nga jodi. Shenja të një mbifunksioni të gjëndrës tiroide mund të jenë pulsi i shtuar, djersitje, pagjumësi, dridhje, heqje barku dhe rënie në peshë, megjithë shtimin e oreksit. Në këto raste duhet thirrur mjeku.

Të panjohura (Shpeshtësia nuk mund të përcaktohet në bazë të të dhënave në dispozicion):

- Mund të shfaqet një acarim i mukozës së stomakut, sidomos kur tabletat e jodurit të kaliumit merren me stomak bosh.
- Pezmatim i gjëndrave të pështymës
- Shqetësime në zonën e stomakut dhe të zorrës
- Ekzemë e lehtë

Në përgjithësi duhet pasur parasysh:

Pyesni mjekun a mjeken ose farmacistin a farmacisten tuaj, nëse ju nevojiten më shumë informacione ose ndonjë këshillë tjetër.